L I G J
Nr.9456, datë 21.12.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8982, DATË 12.12.2002
"PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

a) Aneksi nr.4 "Taksa vjetore për regjistrimin e përvitshën të mjeteve të transportit rrugor", që i referohet pikës 2, zëvendësohet me aneksin 4, që i bashkëlidhet këtij ligji;

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të mjetit. Taksa derdhet për llogari të bashkisë ose të komunës, sipas vendbanimit ose selisë së pronarit të mjetit, brenda datës 10 të muajit pasardhës.".

c) Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Policia e Qarkullimit Rrugor kontrollon pagimin e kësaj takse nga zotëruesit e mjeteve dhe, kur vëren se nuk është paguar, zbaton një gjobë të barabartë me masën e taksës. Nëse taksa dhe/ose gjoba nuk paguhen brenda 10 ditëve, ajo bllokon mjetin deri në pagesën e tyre.".

ç) Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

"7. Për mjetet, që regjistrohen për herë të parë, taksa paguhet e plotë, pavarësisht nga periudha e regjistrimit dhe është e vlefshme për 365 ditë.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr., datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

ANEKSI 4
Taksat vjetore për regjistrimin e përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor

Nr.	Tipi i mjetit	Taksë regjistrimi (në lekë)
1	Çiklomotorë	0
2	Motomjete	600
3	Automjete: Autoveturë <=4+1 vende, benzinë Autoveturë <=4+1 vende, naftë Autoveturë >4+1 deri <= 8+1 vende, benzinë Autoveturë>4+1 deri <= 8+1 vende, naftë	 2 400 2 400 4 800 4 800
4	Automjet transporti i përzier deri 3t Automjet transporti i përzier 3t deri <=3,5t	3 600 3 600
5	Kamion: Nga 3,5t – 7,5t Nga 7,5t – 18t Më i madh se 18t	 4 800 6 000 8 000
6	Autobuzë: Nga 8+1 deri <=32+1 vende >32+1 deri <=42+1 vende Mbi 42+1 vende, artikularë	 6 000 7 200 8 400
7	Automjet për përdorim të veçantë: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <=7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18t	 3 600 4 800 6 000 8 000
8	Automjet për transport të veçantë: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga>7,5t deri <=18t Më i madh se 18t	 3 600 4 800 6 000 8 000
9	Tërheqës rrugor	6 000
10	Autokamp	4 800
11	Rimorkio: <= 750 kg (karrel) shtojcë nga > 750kg deri në <= 1500 kg Nga > 1500 kg deri në <= 7000 kg Më i madh se 7000 kg	 3 000 3 000 3 000 4 000
12	Gjysmë rimorkio: <=7000 kg dhe > 7000 kg	4 000
13	Makina bujqësore: <= 3,5t Nga 3,5t deri <=7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18t	 3 000 3 000 3 600 3 600
14	Makina teknologjike: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga > 7,5t deri <=18t Më i madh se 18t	 3 600 4 800 6 000 8 000
15	Mjete rrugore të veçanta: <= me 3,5t	 3 600

	Nga 3,5t deri <=7,5t Nga > 7,5t deri <= 18t Më i madh se 18t	4 800 6 000 8 000